

KUJDES! MOS DËMTO BARKODIN

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
AGJENCIA QENDRORE E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2009

SESIONI I

(I DETYRUAR)

VARIANTI B

E martë, 2 qershor 2009

Ora 10.00

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe
Gjimnazi - drejtimi natyror

Udhëzime për nxënësin

Testi është i ndarë në dy pjesë: në poezi dhe në prozë.

Testi në total ka **25 pyetje**.

Në të dy pjesët ka kërkesa me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në kërkesat me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për kërkesat me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e kërkesave të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8a	8b	8c	9	10a	10b	11a
Pikët														
Kërkesa	11b	12a	12b	12c	12d	13	14	15	16	17	18	19a	19b	19c
Pikët														
Kërkesa	20	21	22a	22b	22c	23	24a	24b	24c	25a	25b	25c		
Pikët														

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

PJESA I**Ismail KADARE****Kinema e vjetër**

Kinema e vjetër,
 Kinema e braktisur,
 Ku prej kohësh më s'lozin filma të përsëritur,
 Ku s'bëjnë më zhurmë njerëzit me karriget,
 Ku në pushimet e seancave
 S'shesin kikirikë.

Ekrani me njolla,
 Megafonët prishur,
 Stolat janë boshe si radhë të pashkruara;
 Këtë poemë stolash të gjatë, të braktisur
 Nga dera e vështroj
 Plot mall e i menduar.

Kinema e femënisë,
 Kinema e rrëmujës,
 Kam parë aq vende,
 Kam parë aq salla,
 Por n'asnjë prej tyre s'kam hyrë me aq bujë,
 Sa tek ti,
 E shtrenjta barakë,
 E rralla!
 Më mirë asgjëkund veten s'e kam ndier,
 As në sallat luksoze me kadife që shndrit,
 Megjithëse në to me leshverdha kam qenë,
 Kurse tek ti vija
 Me jevgun Rakip.

Lekë, lekë,
 Të mbledhura me mundim paret,
 Tingulli i gëzuar në biletari,
 Afishet tek xhamia
 Dhe tek Qafë e Pazarit
 Të shkruara nga vetë portieri Qani.

Për të njëjtin film tek njëra afishe
 Shkruhej titulli ndryshe,
 Te tjetra.
 Por kjo asnjëri punë s'i prishte.

T'i falnin ty të gjitha,
 E dashura,
 E vjetra.
 Në atë copë ekran,
 Për herë të parë,
 Një copë të botës së gjerë ne pamë.
 Në gjashtë metra katrore.

Bota fund s'kish e anë,
 Bota ngjante e shkëlqyer,
 Ndonëse ekrani ish me arna.

Dhe ne ishim me arna,
 Me arna ish Republika,
 Koha, bërrylat, shtetet ishin me arna.
 Por në sytë tanë
 Kish të tillë dritë,
 Që nuk e patën kurrë
 Më të ndriturat ekrane.

Kinema e vjetër,
 Kinema e braktisur,
 Stola ku janë ulur varg
 Ditët e femënisë,
 Cicëronjëse gjithmonë
 Si një rresht zogjsh
 Mbi një tel telefoni.

Kinema e vjetër,
 Kinema e braktisur,
 Stola të rëndë, të gjatë, të vithisur.
 Në çdo moshë që të hyj,
 Në çdo vend që të vete
 Si hamall këto stole
 Do t'i marr me vete.

Për pyetjet 1-7 rrethoni **vetëm** shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

1. Tema qendrore e kësaj poezie (pjesë e boshtit tematik të veprës së Kadaresë), na çon te rikthimi në: 1 pikë
 - A) traditën e të parëve.
 - B) historinë e lashtë.
 - C) dashurinë e harruar.
 - D) fëmijërinë e hershme.

2. Fjala *asgjëkund* bën pjesë në klasën e fjalëve të: 1 pikë
 - A) emrit
 - B) ndajfoljes
 - C) mbiemrit
 - D) foljes

3. Në vargun “*Ekrani me njolla*”, emri *njolla* tregon se: 1 pikë
 - A) e vjetra nuk pëlqehet.
 - B) koha lë gjurmët e saj.
 - C) objekti dallohet vetëm nga njollat.
 - D) njolla është e domosdoshme në ekran.

4. Heroi në këtë poezi vendoset përballë: 1 pikë
 - A) sfidave të kohës: shpirtërore, mendore, fizike.
 - B) indiferencës dhe rrënimit si qenie njerëzore.
 - C) armiqësive të shumta e komplekse që e çojnë atë në dështim.
 - D) rrugëtimeve të gjata e pa krye, ku nuk gjen dot vetveten.

5. Poezia *Kinema e vjetër* klasifikohet në gjininë: 1 pikë
 - A) epike
 - B) lirike
 - C) dramatike
 - D) epiko-lirike

6. Premtimi i heroit në vargjet e fundit është: 1 pikë
 - A) kujtimet e fëmijërisë do t’i kem gjithnjë me vete.
 - B) do ta kërkoj dashurinë larg.
 - C) do të ndryshoj me kohën.
 - D) në harresë do të kërkoj shpëtim.

7. Vargu “*E shtrenjta barakë, e rralla!*” është ndërtuar mbi figurën e: 1 pikë
 - A) antitezës
 - B) krahasimit
 - C) inversionit
 - D) ironisë

8. Në këtë poezi ndeshim kombinimin e vargut të shkurtër me atë të gjatë. Gjeni nga një shembull për secilin rast në strofën e parë dhe shpjegoni efektin e këtij kombinimi.

a) shembulli 1: _____ **1 pikë**

b) shembulli 2: _____ **1 pikë**

c) efekti: _____ **1 pikë**

9. Në poezi thuhet: “*ekrani ish me arna...*”. Evidentoni dy shembuj të tjerë, ku fjala arna ndërton paralelisht panoramën e një kohe të vështirë.

2 pikë

10. Cili është objekti që e lidh heroin me botën e fëmijërisë? Gjeni një mbiemër që e karakterizon atë.

a) objekti: _____ **1 pikë**

b) mbiemri: _____ **1 pikë**

11. Nga ç’këndvështrim flet heroi në vargjet “*kam parë aq vende, kam parë aq salla...*”? Shpjegoni raportin që krijojnë ato me kinemanë e dikurshme.

a) këndvështrimi: _____ **1 pikë**

b) shpjegimi: _____ **1 pikë**

PJESA II**Albert KAMY****I huaji (fragment)**

Ky fragment është shkëputur nga pjesa e dytë e veprës së Kamysë “ I huaji”. Është momenti kur Merso, personazhi kryesor, pasi ka marrë dënimin për krimin e kryer, vizitohet në qelinë e tij nga prifti, i cili kërkon pendesën e Mersosë.

Prifti më thoshte me siguri se kërkesa ime për falje, mund të pranohej, por unë do të mbaja me vete peshën e një krimi, nga i cili duhet të çlirohesh. Sipas tij drejtësia e njerëzve nuk ishte asgjë, ndërsa ajo e Zotit ishte gjithçka. Vura në dukje se më kishte dënuar ajo e para. Ai m'u përgjigj se ajo nuk e kishte larë mëkatin tim. I thashë se nuk e dija se çfarë është një mëkat. Më kishin mësuar të kuptoja se isha vetëm një fajtor. Isha fajtor dhe për këtë po paguaja, nuk mund të më kërkonin asgjë tjetër. Në këtë moment, ai u ngrit përsëri dhe mendova se nëse donte të lëvizte në këtë qeli kaq të ngushtë nuk do të kishte mundësi. Duhej ose të ulej ose të ngrihej.

I kisha sytë të fiksuar përdhe. Bëri një hap drejt meje dhe ndaloi, sikur të mos guxonte të bënte më përpara. Vështronte qiellin nëpërmjet hekurave të dritares.

“- Gaboheni, biri im, - më tha ai, - mund t'ju kërkojnë më shumë. Ndoshta do t'ju kërkojnë...

- Çfarë mund të më kërkojnë?

- Mund t'ju kërkojnë që të shihni.

- Çfarë?

Prifti vështroi përreth tij dhe u përgjigj papritur me një zë të lodhur: gjithë këta gurë djersinë dhembje, e di mirë. Gjithmonë i kam shikuar me ankth. Por, në thellësi të zemrës, e di mirë që më mjeranët nga ju kanë parë që nga errësira e tyre ka dalë një fytyrë e shenjtë. Ju kërkohet që të shihni pikërisht këtë fytyrë.”

Sikur u gjallërova pak. I thashë se kishte muaj që shikoja këto mure të trashë. Nuk kishte asgjë dhe asnjë njeri që të mund ta njihja më mirë se këto mure. Ndoshta para disa kohësh, kisha kërkuar dhe unë të gjeja aty një fytyrë. Por kjo fytyrë kishte ngjyrën e diellit dhe flakën e dëshirës: ishte fytyra e Marisë. E kisha kërkuar më kot aty brenda. Tashmë çdo gjë kishte marrë fund. Gjithsesi, në asnjë rast nuk kisha parë të shfaqej ndonjë gjë nga kjo djersë që lëshonin gurët.

Sapo ai iku, rigjeta përsëri qetësinë time. Isha i dërmuar dhe u hodha mbi dyshekun tim. Mendoj se më kishte zënë gjumi pasi u zgjova dhe pashë yjet sipër kokës. Zhurmat e fshatit vinin deri tek unë. Aromat e natës, të tokës dhe të kripës freskonin tëmthas e mi. Paqja e mrekullueshme e kësaj vere të përgjumur futej tek unë si një vërshim i papërmbajtshëm. Në këtë moment që përkonte dhe me fillimin e agimit të ditës së re, ulërinë sirenat. Ato më njoftonin nisjen për në një botë tjetër, për të cilën nuk isha më indiferent. Për herë të parë, që prej shumë kohësh mendova për mamanë. E kuptova se përse në fund të një jete ajo kishte gjetur “një të fejuar”, se përse ajo kishte filluar të luante për të rifilluar edhe njëherë nga e para. Edhe atje, atje, përreth kësaj azileje ku shuheshin jetë, mbrëmja ngjante me një pushim melankolik. Kaq pranë vdekjes, mamaja duhet të jetë ndjerë e lirë dhe e gatshme për të rijetuar edhe njëherë gjithçka. Asnjë, por asnjë nuk kishte të drejtë të qante mbi të. Dhe unë gjithashtu u ndjeva gati për të jetuar përsëri. Sikur gjithë ky zemërim më kishte pastruar nga e keqja, më kishte boshatisur nga shpresa, përpara kësaj nate të mbushur me shenja dhe yje po i hapsha për herë të parë indiferencës së butë të kësaj bote.

Për pyetjet 13-18 rrethoni **vetëm** shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

- 13.** Cila konsiderohet pika më e fortë e romanit dhe që shërben si mjet komunikimi me lexuesin? **1 pikë**
- A) Komentet e zgjatura.
B) Figuracioni i pasur.
C) Rrëfimi në vetën e parë.
D) Personazhet e shumta.
- 14.** Shprehja “një të fejuar” është futur në thonjëza: **1 pikë**
- A) për të dhënë dëshirën e individit për të rifilluar nga e para.
B) për të dhënë kontrastin midis burrit dhe gruas.
C) për të treguar vlerën e një veprimi si fejesa.
D) për të thënë thjesht se çfarë kishte bërë mamaja.
- 15.** Jeta e personazhit kryesor Merso paraqitet si një lojë e pamëshirshme midis: **1 pikë**
- A) kujtesës dhe harresës.
B) së bukurës dhe së shëmtuarës.
C) realitetit dhe ëndrrës.
D) absurdit dhe njeriut.
- 16.** Fjala *i huaj* është e lidhur në këtë vepër me një njeri, i cili: **1 pikë**
- A) vjen nga një vend i largët dhe i huaj.
B) flet një gjuhë të huaj dhe të padëgjuar më parë.
C) ndryshon shpesh mendim, në marrëdhënie me veten.
D) ndihet vazhdimisht i huaj në mjedisin ku jeton.
- 17.** Ngjarjet në vepër rrjedhin fatalisht sikurse ndodh në veprat e: **1 pikë**
- A) Rilindjes
B) Antikitetit
C) Realizmit
D) Romantizmit
- 18.** Ligjërata e zhdrejtë në paragrafin e parë jep: **1 pikë**
- A) tiparin e një stili të ngjeshur dhe të veprimit që ndodh shpejt.
B) indiferencën e priftit ndaj Mersoit.
C) marrëdhënien e personazhit me natyrën.
D) dëshirën e Mersoit për të qenë i pushtetshëm.
- 19.** Në paragrafin e parë lexuesi ndeshet me dy lloj drejtësish. Identifikoni ato. Në ç’ marrëdhënie ndodhen dy drejtësitë dhe cili është mjeti gjuhësor që e realizon këtë? **1 pikë**
- a) dy drejtësitë: _____ **1 pikë**
- b) marrëdhënia midis tyre: _____ **1 pikë**
- c) mjeti gjuhësor: _____ **1 pikë**

20. Sikundër në të gjithë veprën edhe këtu dielli kryen një funksion të veçantë. Çfarë dëshire i zgjon imazhi i tij Mersosë? **1 pikë**

21. Në secilin nga paragrafët kemi një gjendje të personazhit kryesor. Jepni kuptimin e çdo paragrafi me një fjali të thjeshtë. **4 pikë**

Fjalja I: _____ Fjalja II: _____

Fjalja III: _____ Fjalja IV: _____

22. Merso po shkon drejt ekzekutimit. Pse ai nuk mund ta shmangë atë? Çfarë ndjesie ju krijon kjo gjë? Cilët personazhe të veprës kanë më përpara se Merso pikëtakimi me vdekjen?

a) pse nuk shmanget: _____ **1 pikë**

b) ndjesia: _____ **1 pikë**

c) personazhet: _____ **1 pikë**

23. Kamy shprehet: *“te njeriu ka më shumë gjëra për t’u admiruar sesa për t’u përbuzur”*. Çfarë tregon kjo? Argumentoni nëse e gjejmë të shprehur këtë mendim te Merso? **3 pikë**

24. Nga e kupton Merso që kishte ardhur momenti për t’u nisur në botën tjetër? Cili është sinjali që e njofton atë në paragrafin e fundit?

Shpjegoni pse ai nuk është më indiferent ndaj jetës. Gjeni të paktën dy fjalë kyçe për ta ilustruar këtë.

a) sinjali: _____ **1 pikë**

b) shpjegimi: _____ **1 pikë**

c) fjalët kyçe: _____ **1 pikë**

25. Stili i Kamysë shfaq disa tipare. Gjeni një tipar të tij të përdorur në këtë fragment. Shpjegoni përdorimin duke e ilustruar me shembull.

a) tipari i zgjedhur: _____ **1 pikë**

b) shpjegimi: _____ **1 pikë**

c) shembulli: _____ **1 pikë**